

VENDIM
Nr. 759, datë 20.12.2017

**PËR DHËNIEN E STATUSIT “VARREZË HISTORIKE” VENDPREHJES SË
USHTARËVE TË RËNË GJATË LUFTËS ITALO-GREKE TË VITEVE 1940–1941, ME
VENDNDODHJE NË FSHATIN BULARAT, BASHKIA DROPULL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të marrëveshjes së bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë, për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin dhe varrimin e ushtarakëve grekë, të rënë në Shqipëri gjatë luftës greko-italiane të viteve 1940–1941, dhe për ndërtimin e vendprehjes për ta, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, ratifikuar me ligjin nr. 10256, datë 25.3.2010, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 3/ç, të ligjit nr. 9220, datë 15.4.2004, “Për administrimin e shërbimit të varrimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, ministrit të Brendshëm, ministrit të Mbrojtjes dhe ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e statusit “Varrezë historike”, vendprehjes (varrezës) së ushtarëve të rënë gjatë luftës italo-greke të viteve 1940–1941, me vendndodhje në fshatin Bularat, Bashkia Dropull.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Bashkia Dropull për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi